



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
DHOMA PENALE

Rr Jordan Misja, Tiranë, adresë web: [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)

**NJOFTIM PËR SHTYP**

Referuar interesit të shfaqur mediatik, komunikohet informacioni zyrtar në vijim:

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin e arsyetuar, me numër 1575/1, datë 11.10.2022, pasi ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit për “*Vleftësimin e arrestit të kryer në flagrancë*” si dhe “*Caktim mase sigurimi*”, ndaj personit nën hetim **Fatjon Murati**, ka vendosur: “*Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg*” ndaj personit nën hetim **Fatjon Murati**.
2. Me vendimin Nr. 1575/2, datë 28.12.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>1</sup>, Gjyqtari i hetimit paraprak, pasi ka shqyrtuar kërkesën me objekt: “*Zëvendësimin e masës së sigurimit caktuar ndaj personit nën hetim Fatjon Murati*”, pasi ka administruar: provat shkresore (të dorëzuara nga palët), të gjitha rrethanat e reja, të ndryshuara, ka konstatuar ndryshimin/zbutjen e akuzës penale në ngarkim të këtij shtetasi, nga vepra penale e “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit*” parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, në atë të parashikuar nga neni 278 paragrafi i 3-të i Kodit Penal (për të cilin parashikohet një marzh dënimi 1-3 vjet burgim), ka verifikuar të gjitha rezultatet në të cilat ka arritur hetimi paraprak, i cili ka rezultuar i përfunduar, të cilat në zbatim të **nenit 260 të K.Pr.Penale**, ndryshonin dhe zbutnin ndjeshëm pozitën procedurale të këtij shtetasi, në kuadër të këtij procedimi penal, referuar të gjitha argumenteve ligjore, të pasqyruara në vendimin e arsyetuar, Gjykata ka vendosur: “*Zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në atë të “Arrestit në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit/ tashmë në cilësinë e të pandehurit Fatjon Murati.

<sup>1</sup> Shiko arsyetimin e vendimit Nr. 1575/2, datë 28.12.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Në datën 16.01.2023, ky vendim ka marrë formë të prerë, i pa-ankimuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse.
4. Në datën 17.01.2023, është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, kërkesa me objekt: *“Dërgimin e çështjes në gjyq, për të pandehurin Fatjon Murati, i akuzuar për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”*, parashikuar nga neni 278 paragrafi i 3-të i Kodit Penal.
5. Në datën 20.01.2023, është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, kërkesa me objekt: *“Dërgimin e çështjes në gjyq, për të pandehurin Fatjon Murati, i akuzuar për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”*, parashikuar nga neni 278 paragrafi i 3-të i Kodit Penal.
6. Në datën 27.02.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtari i seancës paraprahe, ka disponuar me vendim për *“Dërgimin e çështjes penale në gjyq”*, në séance themeli, dhe vijimin e gjykimit të kësaj çështje, në kuadër të gjykimit me ritin e posaçëm, atë të Gjykimit të Shkurtuar. Aktualisht çështja penale vijon në gjykim.
  - Bashkëngjitur këtij komunikimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendos në dispozicion kopjet e anonimizuara<sup>2</sup> të vendimeve të sipër cituara (*të disponuara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*), në formatin **PDF**.
  - Bazuar në **nenet 103, 104, 105 të Kodit të Proçedurës Penale**, ndalohet publikimi i akteve (*sekrete dhe jo sekrete*), qoftë edhe i pjesshëm i tyre, deri në përfundimin e hetimeve paraprahe, sikurse edhe i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura.

*Koordinatorë për të drejtën e informimit,  
pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,*

***Ola Ismaili***

*e-mail: [oismaili@gjykatatirana.gov.al](mailto:oismaili@gjykatatirana.gov.al)*

*tel: +355 69 53 35 955*

---

<sup>2</sup> Në zbatim rigoroz të neneve 103, 104, 105 të Kodit të Proçedurës Penale.